




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT



NR. 7 VENDIMI

Tiranë, më 23.03.2018

VENDIM

Trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e përbërë nga:

<b>Roland Ilia</b>	Kryesues
<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Anëtar
<b>Xhensila Pine</b>	Relator

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore znj.Ina Serjanaj;  
pas shortimit të shpërndarjes së çështjes dhe caktimit të kryesuesit dhe relatorit, sot, në datën 23.03.2018, ora 15:00, në sallën nr. 1 të selisë së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

**Znj.Etleva Sherifi - Ndhmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë**

**BAZA LIGJORE :** Neni 179/b, pika 4, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 14, 56 e 57, të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Arsyet për pushimin e procesit të rivlerësimit:**

Subjekti i rivlerësimit Znj. Etleva Sherifi, ka ushtruar funksionin e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

Ky subjekt, ka dhënë dorëheqjen nga detyra që ushtronte, duke e paraqitur këtë dorëheqje, me shkrim, pranë Institucionit të Presidentit të Republikës. Kjo dorëheqje është protokolluar tek ky institucion, me nr.15/E prot., datë 31.03.2017.

Presidenti i Republikës e ka publikuar këtë fakt në faqen zyrtare të institucionit dhe nëpërmjet shkresës nr.688/1 prot., datë 19.03.2018, ka njoftuar Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për dorëheqjen e subjektit të rivlerësimit Znj. Etleva Sherifi.

Neni 56 i ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë" ka parashikuar mundësinë e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit si vijon:

1. *Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit.*
2. *Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1, të ligjit "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit".*

Referuar parashikimit kushtetues të nenit 84/3<sup>1</sup>, datës së miratimit të ligjit nga Parlamenti dhe datës së botimit të ligjit në Fletoren Zyrtare nr. 180, datë 23.09.2016, si dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin<sup>2</sup> dhe rrëzimin e kërkesës për shfuqizim<sup>3</sup>, ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë" hyri në fuqi në datën 8.10.2016. Në datën 25.10.2016, ligji u pezullua nga Gjykata Kushtetuese. Për këtë arsye, afati i zbatimit të ligjit eci për 17 ditë deri në datën 25.10.2016. Në datë 18.01.2017, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën për shfuqizimin e ligjit. Ky vendim u botua në Fletoren Zyrtare në datën 19.01.2017. Si rezultat afati 3-mujor, parashikuar nga neni 56, ka përfunduar në datën 31 mars 2017.

Paraqitja e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit brenda këtij afati, sjell si pasojë pushimin e procedurës së rivlerësimit, duke i dhënë këtij subjekti të drejtat e parashikuara në pikën 2, të nenit 56, të ligjit nr. 84/2016.

<sup>1</sup>Presidenti i Republikës shpall ligjin e miratuar brenda 20 ditëve nga paraqitja e tij.

Ligji quhet i shpallur, në qoftë se Presidenti i Republikës nuk ushtron të drejtat e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni dhe në paragrafin 1, të nenit 85. Ligji hyn në fuqi me kalimin e jo më pak se 15 ditëve nga botimi i tij në Fletoren Zyrtare.

<sup>2</sup>Pas miratimit nga Parlamenti në datën 22 korrik 2016, dhe kalimit të afatit 20-ditor, ligji hyri në fuqi në datën 8.10.2016. Në datën 25.10.2016, mbledhja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese vendosi pezullimin e zbatimit ligjit nr.84/2016 dhe kërkimin e *amicus curia* nga Komisioni i Venecias në lidhje me pajtueshmërinë e tij me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

<sup>3</sup> Në datën 18.01.2017, me vendimin nr.2, Gjykata Kushtetuese vendosi rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e ligjit.

## PËR KËTO ARSYE:

Trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenet 56 dhe 57, të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 165, pika 1, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## V E N D O S I:

Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për Znj. Etleva Sherifi, ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë, është pushuar.

Ky vendim u njoftohet Znj. Etleva Sherifi, Komisionerëve Publikë dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Ankimi kundër këtij vendimi bëhet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

## ANËTARËT E TRUPËS GJYKUESE

**ROLAND ILIA**

**Kryesues**



**XHENSILA PINE**

**Relator**

**GENTA TAFA (BUNGO)**

**Anëtar**

Ky vendim shpallet në datën 23.03.2018.